



Npi – 01/220 datë: 26.06.2024

Duke u bazuar në nenet 12.2 shkronja (d), 14, dhe neni 17 shkronja (c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr.28/2008); Nenin 2 i Ligjit të Kosovës për Eksproprijim (Ligji i vjetër i Eksproprijimit sipas të cilit është dhënë prona komunale në shfrytëzim); Nenin 22 të Ligjit, Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës; Nenin 27 të Rregullores të QRK-së me Nr.09/2020 për përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës; Statutin e Komunës së Shtimes 01Nr.06/1636 të datës 03.09.2008, Kuvendi i Komunës, duke shqyrtuar propozimin e Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi Nr.02/653 të datës 18.06.2024, si dhe Rekomandimin e MAPL-së Nr.020-256/18-2024 të datës 13.06.2024 në seancën e mbajtur më 26.06.2024 miratoi këtë:

## **V E N D I M**

### **PËR NDRYSHIMIN E BAZËS LIGJORE TË VENDIMIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË SHTIMES Npi-01/178 TË DATËS 29.05.2024**

#### **I**

Kuvendi i Komunës së Shtimes, në seancën e -VI- të rregullt për vitin 2024, të mbajtur më 26.06.2024, me shumicën e votave miratoi vendimin për ndryshimin e vendimit të Kuvendit të Komunës së Shtimes me numër Npi-01/178 të datës 29.05.2024 për marrjen e të drejtës së shfrytëzimit të Ngastres Kadastrale me numër P-72809093-02148-4. Zona Kadastrale – Shtime. Me sipërfaqe prej 2000m<sup>2</sup>. Kualiteti - Mal i klasës së dytë. Evidentuar Pasuri Shoqërore e Komunës – Shfrytëzues NPKSH – “Higjiena” Komuna Shtime, ndryshimi është bërë te baza ligjore si vijon:

*“Duke u bazuar në nenet 12.2 shkronja (d), 14, dhe neni 17 shkronja (c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr.28/2008); Nenin 2 i Ligjit të Kosovës për Eksproprijim (Ligji i vjetër i Eksproprijimit sipas të cilit është dhënë prona komunale në shfrytëzim); Nenin 22 të Ligjit, Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës; Nenin 27 të Rregullores të QRK-së me Nr.09/2020 për përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës; Statutin e Komunës së Shtimes 01Nr.06/1636 të datës 03.09.2008”.*

#### **II**

A r s y e t i m: Komuna e Shtimes me vendimin Nr.01/347/2 të datës 27.09.2002 i ka dhënë në shfrytëzim të përkohshëm NPKSH “Higjiena” – Shtime, (tani – KRM-“Pastërtia”) sipërfaqen e tokës prej 2000m<sup>2</sup> në N.K. P-72809093-02148-4; Z.K –Shtime, për objektin e administratës e autoparkun. Duke marrë për bazë Marrëveshjen Nr.02/354 të datës 27.10.2022, të Ministrisë të Punëve të Brendshme (MPB) dhe Komunës së Shtimes për Bashkëfinancim dhe Realizim të Projektit “Ndërtimi i Objektit të Komunës së Shtimes” në vlerën totale 2.5 milion euro, të cilat janë buxhetuar në Buxhetin e Republikës së Kosovës, është paraqitur nevoja për sigurimin e lokacionit, meqenëse Komuna e Shtimes nuk posedon paluajtshmëri e cila i plotëson kushtet për ndërtimin e objektit të ri të administratës, atëherë, Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi i ka propozuar Kuvendit miratimin e vendimit, sipas dispozitivit të këtij vendimi.

Ndryshimi i Vendimit të Kuvendit të Komunës së Shtimes Npi-01/178 të datës 29.05.2024 është rekomanduar nga MAPL - Nr.020-256/18-2024 më datën 13.06.2024 për arsye se ka qenë e shkruar si vijon:

*“Duke u bazuar në nenet 12.2 shkronja (d), 14, dhe neni 17 shkronja (c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr.28/2008); Nenin 2 i Ligjit të Kosovës për Eksproprijim (Ligji i vjetër i Eksproprijimit sipas të cilit është dhënë prona komunale në shfrytëzim); Statutit të Komunës së Shtimes 01Nr.06/1636 të datës 03.09.2008”.*

### III

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e rexhistrimit në evidencën e protokolit zyrtar në MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb – faqen zyrtare të Komunës së Shtimes.

### IV

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Palëve, Drejtorisë, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal si dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesi Kuvendit  
Adnan Ademi